



FLETORJA ZYRTARE E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.90	2005	30 nëntor
--------------	-------------	------------------

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.733, datë 23.11.2005	Për lejin e Entit Kombëtar të Turizmit, të përdorë procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë” për krijimin dhe botimin e faqes për Shqipërinë, me profil turistik në revistën “Foreign Affairs”..... 2875
Vendim i ERE nr.55, datë 12.10.2005	Për miratimin e licencës së importit të energjisë elektrike brenda territorit të Republikës së Shqipërisë..... 2875
Vendim i ERE nr.56, datë 12.10.2005	Për miratimin e licencës së furnizimit me energji elektrike të klientëve tariforë..... 2881
Vendim i ERE nr.58, datë 14.10.2005	Për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, nga shoqëria “Essegei-Shqipëri-Smokthinë” sh.p.k. për periudhën 1.5.2004-31.12.2004..... 2889
Vendim i ERE nr.59, datë 14.10.2005	Për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, nga shoqëria “Essegei-Shqipëri-Smokthinë”sh.p.k. për vitin 2005.. 2889
Vendim i ERE nr.61, datë 25.10.2005	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit..... 2890
Vendim i ERE nr.67, datë 4.11.2005	Për miratimin e licencës së furnizuesit të kualifikuar për furnizimin e energjisë elektrike të klientëve të kualifikuar..... 2890
Vendim i ERE nr.68, datë 4.11.2005	Për miratimin e rregullores për procedurat e heqjes së një licence..... 2899

Vendim i ERE nr.69, datë 14.11.2005	Për dhënien e licencës për aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike shoqërisë “Kurum Energy” sh.a. për klientin e kualifikuar Kurum International sh.p.k.....	2902
Vendim i ERE nr.70, datë 14.11.2005	Për dhënien e licencës për aktivitetin e importit të energjisë elektrike shoqërisë “Kurum Energy” sh.a. për për klientin e kualifikuar Kurum International sh.p.k.....	2902
Vendim i ERE nr.72, datë 17.11.2005	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit	2903
Vendim i ERE nr.73, datë 17.11.2005	Për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, për shoqërinë “Favina” sh.p.k. për vitin 2005.....	2903

VENDIM
Nr.733, datë 23.11.2005

**PËR LEJIMIN E ENTIT KOMBËTAR TË TURIZMIT, TË PËRDORË PROCEDURËN
“PROKURIM TË DREJTPËRDREJTË” PËR KRIJIMIN DHE BOTIMIN E FAQES PËR
SHQIPËRINË, ME PROFIL TURISTIK NË REVISTËN “FOREIGN AFFAIRS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Entit Kombëtar të Turizmit, që, për fondin prej 3 625 000 (tre milionë e gjashtëqind e njëzet e pesë mijë) lekësh, të përdorë procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë”, me shoqërinë “SML”, Strategic Media Limited, sh.p.k., Qipro, për krijimin dhe botimin e faqes shqiptare, me profil turistik, në revistën “Foreign Affairs”.
 2. Ky fond përballohet nga të ardhurat dytësore, zëri “Promocion” të Entit Kombëtar të Turizmit.
 3. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.55, datë 12.10.2005

**PËR MIRATIMIN E LICENCËS SË IMPORTIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE BRENDA
TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Mbështetur në nenet 9 dhe 13, germa dh të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.10.2005, pasi shqyrtoi draftin e paraqitur nga Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për “Licencën e importit të energjisë elektrike brenda territorit të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Miratimin e licencës së importit të energjisë elektrike brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. (Licenca bashkëlidhur këtij vendimi).
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

Republika e Shqipërisë
Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike

LICENCË
PËR IMPORTIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Seria: _____ Numri i licencës: _____
Data e hyrjes në fuqi: _____
Licenca i jepet: _____
Shoqëria: _____
Kodi fiskal: _____
Certifikata e regjistrimit: _____

Bazuar në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, me vendim të Bordit të Komisionerëve nr. _____, datë _____ Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike (“ERE”) i jep licencën për importin e energjisë elektrike, subjektit _____. Kjo licencë është në fuqi për periudhën nga _____ deri më _____, në rast se nuk hiqet nga ERE, në përputhje me kushtet e kësaj licence.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

Republika e Shqipërisë
Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike

KUSHTET E LICENCËS
PËR IMPORTIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Seria: _____ Numri i licencës: _____
I jepet: _____
(Emri i plotë i të licencuarit)

1. Dispozita të përgjithshme

1.1 ERE është autoriteti i vetëm në Republikën e Shqipërisë, i njohur sipas pjesës së tretë të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, për të lëshuar dhe deklaruar hyrjen në fuqi të kësaj licence.

1.2 Nëse ndonjë kusht i kësaj licence shfuqizohet, ky kusht do të hiqet nga kushtet e licencës, dhe kushtet e mbetura të licencës do të vazhdojnë të jenë plotësisht në fuqi.

1.3 Kjo licencë nuk mund të transferohet, tërësisht ose pjesërisht, tek asnjë person tjetër pa vendim të veçantë me shkrim të ERE-s. Kur aprovon një transferim, ERE mund ta ndryshojë periudhën e licencës ose kushtet e tjera të licencës, pasi të parashtrijë një shkak të arsyeshëm.

1.4 Fjalët dhe frazat e mëposhtme të përdorura në licencë, kushtet e licencës dhe anekset, kur përdoren, do të kenë kuptimet e mëposhtme:

Licencë	Është autorizimi që i jepet një personi, sipas përcaktimeve në pjesën e tretë të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.
Person	Është një person fizik ose juridik.
Transferim	Shitja, pengu, qiraja, shkëmbimi ose çdo formë tjetër disponimi, i plotë ose i pjesshëm, i së drejtës për t’u angazhuar në aktivitetin e licencuar.
I licencuari	Është një person që ka licencën sipas përcaktimeve në pjesën e tretë të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Aktiviteti i licencuar	Aktivitete të nevojshme me qëllim blerjen e energjisë elektrike nga jashtë për në territorin e Republikës së Shqipërisë, me qëllim shitjen e saj brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
Biznesi shoqërues	Çdo biznes tjetër që direkt ose indirekt, tërësisht ose pjesërisht: 1. është pronë e të licencuarit; ose 2. e ka të licencuarin pronë; ose 3. është në pronësi të një personi, i cili është pronë e të licencuarit.
Marrëveshje të shitblerjes së energjisë elektrike	Kontratë e nënshkruar për shitblerjen e energjisë elektrike, e lidhur midis një të licencuari dhe një furnizuesi të energjisë elektrike.
ERE	“Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike” është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike që vepron sipas ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.
Legjislacioni në fuqi	Ligjet e Republikës së Shqipërisë të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë dhe aktualisht në fuqi.
Rregulloret dhe rregullat	Standardet, kodet, rregulloret, urdhrat dhe rekomandime të tjera në fuqi të miratuara nga ERE.
Kodi i Sistemit të Transmetimit (Kodi i Funksionimit të Rrjetit të Transmetimit)	Kodi i Sistemit të Transmetimit është një dokument që përcakton kufijtë, marrëdhëniet ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesve dhe vendos procedurat për operimin dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit, në përputhje me zhvillimin e tregut shqiptar dhe rajonal të energjisë elektrike.
Kodi i Funksionimit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike	Tërësia e rregullave teknike, që rregullojnë funksionimin e rrjetit të shpërndarjes dhe që vendosin kushtet dhe termat e shërbimit të shoqërive të shpërndarjes për konsumatorët.
Kodi i Matjes së KMEE Energjisë Elektrike	përcakton kërkesat minimale teknike të ndërtimit dhe shfrytëzimit të sistemit të matjes së energjisë elektrike, i cili do të jetë i përshtatshëm për matjen, regjistrimin, mbledhjen e të dhënave dhe zbatimin e procedurave përkatëse sipas rregullave të tregut të energjisë elektrike, marrëveshjeve midis palëve dhe legjislacionit në fuqi.
Rregullat e tregut	Janë rregullat e veprimit dhe menaxhimit të tregut, si dhe të marrëdhënieve tregtare ndërmjet mbajtësve të licencës.
Energji elektrike	Energjia elektrike aktive dhe energjia elektrike reaktive.
Pagesë rregullimi	Pagesat vjetore të vendosura nga ERE për veprimtaritë e licencuara, që janë objekt i rregullimit.
Përdorues i sistemit	Persona fizikë dhe juridikë që kryejnë veprimtari të

të transmetimit	licencuara në sistemin elektroenergjetik si prodhuesit, shpërndarësit, klientët e kualifikuar, furnizuesit, si dhe çdo person juridik që përfiton nga shërbimet e transmetimit.	
Sistemi elektroenergjetik	Një sistem i ndërlidhur që përbëhet nga centrale gjenerimi të energjisë elektrike, linja, nënstacione dhe elemente të tjera për transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.	
Ndërprerjet e importit të energjisë elektrike për shkak defekteve	Ndërprerje e importit të energjisë elektrike si rezultat i avarive të elementeve në sistemin elektroenergjetik (elementët mund të jenë linja, transformator në një nënstacion, një njësi gjeneruese etj.).	të
Import	Lëvizja e fluksit të energjisë elektrike nga impiante ose instalime elektrike të një vendi, në impiante ose instalime elektrike të një vendi tjetër, në përputhje me marrëveshjet e lidhura nga i licencuari për blerjen dhe transmetimin e energjisë elektrike me qëllim shitjen të licencuarit e tjerë.	
Aktivitet dispeçerues	Operimi i sistemit elektroenergjetik duke marrë parasysh programimin dhe ruajtjen e sigurisë operative dhe parametrave të cilësisë sipas kushteve teknike.	

2. Kushtet për kryerjen e aktivitetit të licencuar

2.1 I licencuari autorizohet nga kjo licencë për të ushtruar aktivitetin e licencuar për importin e energjisë elektrike jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me qëllim shitjen tek të licencuarit.

2.2 I licencuari nuk do të angazhohet në asnjë formë aktiviteti monopol ose antikonkurrencë të ndaluar nga legjislacioni në fuqi dhe rregulloret dhe rregullat e miratuara nga ERE.

2.3 I licencuari do ta kryejë aktivitetin e licencuar në përputhje me parimet e efikasitetit ekonomike dhe objektivin e arritjes së kostos më të ulët.

2.4 I licencuari do të informojë ERE-n për ngritjen e çdo biznesi shoqëruar. ERE mund të ndalojë ose imponojë kushte për ngritjen e biznesit shoqëruar, të nevojshme për të mbrojtur konsumatorët e Republikës së Shqipërisë.

2.5 I licencuari nuk do të pengojë ose përpikët të parandalojë të licencuarit e tjerë ose konkurrentët potencialë që të angazhohen ose të hyjnë në mënyrë të ligjshme në biznesin e sektorit të energjisë elektrike në Republikën e Shqipërisë.

2.6 Gjithë marrëveshjet e shitblerjes së energjisë elektrike duhet të përputhen me Rregulloren për Marrëveshjet e Blerjes së Energjisë të miratuar nga ERE.

3. Detyrimet e të licencuarit

3.1 I licencuari do të zbatojë legjislacionin shqiptar në fuqi, si dhe rregulloret dhe rregullat e miratuara nga ERE.

3.2 I licencuari do të mbajë për aktivitetin e licencuar llogari të ndara nga aktivitetet e tjera, në përputhje me nenet 23 dhe 33 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike".

3.3 Të licencuarit i kërkohet të përgatisë dhe t'i dorëzojë ERE-s brenda datës 31 mars të vitit nga marrja e licencës, si dhe në çdo kohë brenda një afati të caktuar, kur çmohet e domosdoshme nga ERE, një raport vjetor lidhur me veprimtarinë e tij gjatë vitit kalendarik të mëparshëm që të përmbajë sa më poshtë:

- një përmbledhje dhe analizë të aktivitetit të importit të të licencuarit,
- sasinitë e energjisë së importuar, si dhe çmimin e blerjes dhe shitjes së energjisë,
- çdo ndërprerje të importit të energjisë elektrike për shkak të difekteve në sistemin elektroenergjetik,
- një përmbledhje dhe analizë të kontratave të lidhura për shitblerjen e energjisë elektrike në fuqi gjatë vitit që raportohet,
- bilancin financiar të aktivitetit të licencuar.

3.4 I licencuari do t'i dorëzojë me kërkesën e ERE-s në formën dhe brenda afatit të vendosur nga ERE, çdo informacion të nevojshëm për ERE-n.

3.5 I licencuari do ta njoftojë ERE-n brenda 10 ditëve për çdo ndryshim të:

- Adresës;

- b) Statutit të të licencuarit;
- c) Certifikatës së regjistrimit;
- d) Kodit fiskal;
- e) Menaxherët kryesorë.

3.6 Gjithë njoftimet zyrtare, aplikimet, peticionet dhe deklaratat, lidhur me licencën, duhet të jenë me shkrim.

3.7 I licencuari duhet të përmbushë detyrimet e sigurimit të të dhënave dhe informacionit për rregullatorin dhe të licencuarit e tjerë, konform rregullave të përcaktuara nga ERE.

3.8 I licencuari, gjatë kryerjes së aktivitetit të licencuar do të zbatojë të gjitha kërkesat e përcaktuara në Kodin e Sistemit të Transmetimit (Kodi i Funksionimit të Rrjetit të Transmetimit), Kodin e Funksionimit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Kodin e Matjes së Energjisë Elektrike, si dhe në rregullat e tregut të energjisë.

4. Përdorimi i informacionit

4.1 I licencuari do të sigurojë që çdo informacion i marrë nga të tjerë, si rezultat i aktivitetit të tij të licencuar, nuk do t'i jepet askujt, me përjashtim të rasteve kur:

- a) jepet pëlqimi paraprak me shkrim i personit me të cilin lidhet informacioni,
- b) informacioni është bërë publik,
- c) të licencuarit i kërkohet ose i lejohet ta përhapë informacionin:
 - i) për të përmbushur kushtet e kësaj licence,
 - ii) për të zbatuar një urdhër të ERE-s
 - iii) ose çdo dispozitë ligjore të aplikueshme.

4.2 I licencuari do të sigurojë që bizneset shoqëruese nuk do të përdorin asnjë informacioni që disponon i licencuari për të fituar një avantazh konkurrues të pajustificuar, dhe do të sigurojë që nuk do ta përhapin informacionin tek asnjë person tjetër (përfshirë ata të një biznesi tjetër shoqërues) gjë që mund ta mundësojë këtë person të fitojë çdo lloj avantazhi komercial të pajustificuar.

4.3 Informacioni i dërguar ERE-s nga i licencuari do të konsiderohet publik me përjashtim të rasteve, kur me kërkesë specifike të të licencuarit, ERE me vendim përcakton që ky informacion është i natyrës pronësore dhe se interesi publik i shërbyer nga përhapja e informacionit nuk do ta justifikojë ose kompensojë dëmin potencial komercial që i shkaktohet të licencuarit.

5. Pagesat e rregullimit

5.1 I licencuari do të kryejë pagesa rregullimi në mënyrë të rregullt e të vazhdueshme gjatë afatit të kësaj licence, siç përcaktohet nga ERE, në përputhje me nenin 12 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe rregulloret e aplikueshme të ERE-s.

5.2 Nëse i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit sipas paragrafit 5.1 brenda afatit të kërkuar nga ERE, atëherë ai do të penalizohet, në përputhje me nenin 64 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

6. Kontrolli mbi kryerjen e aktivitetit të licencuar

6.1 ERE do të monitorojë zbatimin nga i licencuari të kushteve të licencimit, do të shqyrtojë raportet e marra nga i licencuari dhe, në çdo kohë, është i autorizuar të inspektojë librat e llogarive të të licencuarit dhe mund të kërkojë një auditim teknik dhe/ose kontabël të aktiviteteve të të licencuarit.

6.2 Përfaqësues të autorizuar të ERE-s kanë të drejtë të inspektojnë dhe të kontrollojnë ambientet e të licencuarit, dhe dokumentacionin e tij për të verifikuar kryerjen e aktivitetit të licencuar në përputhje me kushtet e licencës, si dhe rregulloret dhe rregullat e ERE-s. I licencuari do të sigurojë çdo ndihmë të kërkuar, të nevojshme për ERE-n gjatë këtij inspektimi.

6.3 Në bazë të ankesës së vërtetuar të çdo pale të tretë, ose kryesisht me iniciativën e saj, ERE mund të nisë një hetim mbi zbatimin nga i licencuari të kushteve të licencës së tij ose rregulloreve dhe rregullave të ERE-s.

6.4 I licencuari do të informojë ERE-n duke dhënë shpjegimet dhe arsyet për çdo shkelje të këtyre kushteve të licencës, brenda një jave që kjo shkelje i bëhet e njohur të licencuarit.

6.5 I licencuari do t'u bindet vendimeve të marra nga ERE, përfshirë pagesën e gjobave të vendosura nga ERE, në përputhje me legjislacionin në fuqi, rregulloret dhe rregullat e ERE-s dhe kushtet e kësaj licence.

7. Raportimi çdo gjashtë muaj nga data që kjo licencë bëhet efektive, i licencuari do t'i paraqesë ERE-s një raport që përmbledh aktivitetin e tij gjatë gjashtë muajve të fundit lidhur me importimin e energjisë elektrike.

8. Amendimi i licencës

8.1 ERE mund të amendojë kushtet e licencës në rast se ato nuk përputhen me:

a) Legjislacionin në fuqi dhe vendimet e Qeverisë së Republikës të Shqipërisë që janë në përputhje me legjislacionin në fuqi;

b) Vendimet e formës së prerë të gjykatave të Republikës së Shqipërisë.

8.2 Në çdo kohë i licencuari ose ERE mund të propozojnë amendamente të tjera për këto kushte licence, përveç atyre të specifikuara në paragrafin 8.1, duke i transmetuar një propozim me shkrim, së bashku me çdo dokument mbështetës, palës tjetër.

8.3 ERE do të marrë vendimin përfundimtar vetëm pasi të marrë në konsideratë interesat e konsumatorëve dhe të të licencuarve të tjerë. Palët e interesuara do të informohen me shkrim për çdo amendament të propozuar. Nëse ERE dhe i licencuari arrijnë një marrëveshje për këto amendamente, kushtet e licencës do të amendohen. Nëse marrëveshja nuk arrihet, i licencuari mund të apelojë në Gjykatën e Shkallës së Parë, Tiranë.

9. Heqja e licencës

9.1 ERE mund t'i heqë licencën të licencuarit, në përputhje me ligjin nr.9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe rregulloret dhe rregullat e ERE-s, kur:

a) i licencuari kërkon revokimin e licencës;

b) i licencuari shkel kushtet e licencës dhe një ose disa detyrime të shprehura në këtë licencë;

c) i licencuari shkel legjislacionin në fuqi;

d) i licencuari deklarohet i falimentuar dhe është i paaftë të përmbushë detyrimet e kushteve të licencës;

e) i licencuari ka marrë licencën duke mashtruar.

9.2 Nëse i licencuari ndryshon statusin e tij ligjor ose nëse aksionari që kontrollon interesat ndryshohet pa autorizimin e ERE-s, licenca bëhet nul (e pavlefshme) dhe anulohet dhe pasuesi i të licencuarit do të aplikojë për një licencë të re, në përputhje me procedurat e ERE-s për dhënien e licencës.

10. Pagesat

I licencuari është i detyruar t'i kryejë ERE-s pagesën e licencës ose pagesa të tjera të aplikueshme sipas ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike".

11. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe e drejta për apelim

11.1 Çdo çështje e diskutueshme ose kërkesë në mes të të licencuarit dhe çdo përdoruesi të sistemit të transmetimit, lidhur me aktivitetin dispeçerues ose kushtet e licencës, do të zgjidhet sa më shumë që të jetë e mundur me mirëkuptim, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret dhe rregullat e ERE-s.

11.2 Nëse zgjidhja nuk arrihet me mirëkuptim, atëherë ERE në bazë të petitionit të çdo personi që është palë në këtë mosmarrëveshje, do ta zgjidhë mosmarrëveshjen dhe do të nxjerrë vendimin e saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret dhe rregullat e saj.

11.3 I licencuari mund të apelojë kundër vendimeve të ERE-s në gjykatë brenda 30 ditëve nga botimi i vendimit në Fletoren Zyrtare, në përputhje me nenin 9 pika 4 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike".

11.4 I licencuari duhet t'u bindet vendimeve të përkohshme të ERE-s në pritje të apelimit në gjykatë.

Republika e Shqipërisë
Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike

LICENCË
PËR IMPORTIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Licenca i jepet:

Seria: _____ Numri i licencës: _____

Data e hyrjes në fuqi të këtij aneksi: _____

ANEKSI A

TERRITORI I AUTORIZUAR PËR AKTIVITETIN E LICENCUAR

[Shoqëria _____, autorizohet të ushtrojë aktivitetin e importit të energjisë elektrike për në territorin e Republikës së Shqipërisë.]

VENDIM

Nr.56, datë 12.10.2005

**PËR MIRATIMIN E LICENCËS SË FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE TË
KLIENTËVE TARIFORË**

Mbështetur në nenet 9 dhe 13, germa ç të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 12.10.2005, pasi shqyrtoi draftin e paraqitur nga Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për “Licencën e furnizimit me energji elektrike të klientëve tariforë”,

VENDOSI:

1. Miratimin e licencës së furnizimit me energji elektrike të klientëve tariforë. (Licenca bashkëlidhur këtij vendimi)

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema**

**Republika e Shqipërisë
Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike**

**LICENCË
PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE
TË KLIENTËVE TARIFORË**

Seria: _____ Numri i licencës: _____
Data e hyrjes në fuqi: _____
Licenca i jepet: _____
Shoqëria: _____
Kodi fiskal: _____
Certifikata e regjistrimit: _____

Bazuar në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, me vendim të Bordit të Komisionerëve nr. _____, datë _____, Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike (“ERE”) i jep licencën për furnizimin me energji elektrike të klientëve tariforë, subjektit _____.

Kjo licencë është në fuqi për periudhën nga deri më _____, në rast se nuk hiqet nga ERE në përputhje me kushtet e licencës.

**KRYETAR I ERE-S
Pjetër Dema**

**Republika e Shqipërisë
Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike**

**KUSHTET E LICENCËS
PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE TË KLIENTËVE TARIFORË**

Seria: _____ Numri i licencës: _____
I jepet: _____
(Emri i plotë i të licencuarit)

1. Dispozita të përgjithshme

1.1 ERE është autoriteti i vetëm në Republikën e Shqipërisë, i njohur sipas pjesës së tretë të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, për të lëshuar dhe deklaruar hyrjen në fuqi të kësaj licence.

1.2 Nëse ndonjë kusht i kësaj licence shfuqizohet, ky kusht do të hiqet nga kushtet e licencës, dhe kushtet e mbetura të licencës do të vazhdojnë të jenë plotësisht në fuqi.

1.3 Kjo licencë nuk mund të transferohet, tërësisht ose pjesërisht, tek asnjë person tjetër pa vendim të veçantë me shkrim të ERE-s. Kur aprovon një transferim, ERE mund ta ndryshojë periudhën e licencës ose kushtet e tjera të licencës, pasi të parashtrojë një shkak të arsyeshëm.

1.4 ERE ka të drejtën ekskluzive për ta ndryshuar atë në rast se kushtet dhe rrethanat kanë ndryshuar. ERE rezervon në mënyrë specifike të drejtën për ta ndryshuar këtë licencë, për përputhjen e saj me dispozitat e Kodit të Transmetimit, Kodit të Shpërndarjes, Kodit të Matjes dhe rregullave të tregut të miratuara nga ana e saj në bazë të legjislacionit në fuqi.

1.5 Fjalët dhe frazat e mëposhtme të përdorura në licencë, kushtet e licencës dhe anekset, kur përdoren, do të kenë kuptimet e mëposhtme:

Shërbimet ndihmëse	Shërbimet e kërkuara për të ruajtur standarde të përcaktuara të sigurisë dhe të cilësisë së energjisë elektrike. Shërbimet ndihmëse përfshijnë: - Kompensimin e energjisë reaktive nga përdoruesit për të ruajtur nivelet standarde të tensionit dhe ulur humbjet në rrjet. - Rregullimin fuqi aktive frekuencë, si dhe rezervat e lidhura me të. - Kompensimin e angazhimeve dhe alokimin e kapaciteteve në linjat e interkonjeksionit.
Biznesi shoqërues	Çdo biznes tjetër që direkt ose indirekt, tërësisht ose pjesërisht: 1. është pronë e të licencuarit; ose 2. ka të licencuarin pronë; ose 3. është në pronësi të një personi, i cili është pronë e të licencuarit.
Territori i autorizuar	Rajon gjeografikisht i kufizuar, i specifikuar në aneksin A të licencës, brenda të cilit i licencuari është i autorizuar të kryejë aktivitetin e licencuar.
Tarifa e përdorimit të rrjetit shpërndarës nga furnizuesi (TPRSH)	Pagesa që i licencuari paguan për përdorimin e faciliteteve të rrjetit shpërndarës për shpërndarje të energjisë elektrike te klientët tariforë, që aprovohen nga ERE herë pas here.
Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit nga furnizuesi (TPRT)	Pagesa që i licencuari paguan për përdorimin e faciliteteve të rrjetit të transmetimit, për transmetim të energjisë elektrike te klientët tariforë, që aprovohet nga ERE herë pas here.
Ndër-subvencionimet	Transferim fondesh ose ndarje kostosh brenda llogarive të të licencuarit ose në mes bizneseve shoqëruese për mbështetje financiare të një aktiviteti ose biznesi me koston e një tjetri.
Shpërndarja	Është transporti i energjisë elektrike në sistemet shpërndarëse të tensionit të mesëm dhe të ulët, duke pasur parasysh shpërndarjen të konsumatori fundor.
Sistemi i shpërndarjes (SSH)	Sistemi i shpërndarjes përfshin zbarat, pajisjet kyçëse/shkyçëse dhe transformatorët në nënstacionet 110/35/20/10 kV, si dhe të gjitha elementet

në nivel tensioni më të ulët së 110 kV në pronësi të kompanisë së shpërndarjes.

Sistemi i transmetimit (ST)	Sistemi i transmetimit të energjisë elektrike përbëhet nga bashkësi linjash elektrike të tensionit të lartë (110 kV, 150 kV, 220 kV, 400 kV), stacione transformuese elektrike ose çdo instalim tjetër, funksioni i të cilave përfshin transmetimin ose interkonjeksionin ndërkombëtar.
Energjia elektrike aktive	Energjia elektrike aktive është fuqia aktive që gjenerohet apo kalon në një qark elektrik gjatë një intervali kohe, duke qenë integrali i caktuar i fuqisë aktive me kufij kohorë. Matet me njësi vat-orë ose shumëzime standarde: 1000 Wh=1KWh 1000 KWh=1MWh 1000 MWh=1GWh 1000 GWh=1TWh=10 ¹² Wh
Energjia elektrike reaktive (VARh)	Energjia elektrike reaktive është integrali i caktuar me kufij kohorë i fuqisë reaktive matur në njësi me volt-ampër reaktive—orë ose shumëzime standarde që është; 1000 VARh = 1 kVARh 1000 kVARh= 1 MVARh 1000 MVARh =1 GVARh 1000 GVARh = 1 TVArh=10 ¹² Varh
Klienti fundor (tarifor)	Klienti (konsumatori) që blen energji elektrike për përdorim vetjak.
ERE	Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike, që vepron sipas ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.
Legjislacioni në fuqi	Ligjet e Republikës së Shqipërisë të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë dhe aktualisht në fuqi, si dhe gjithë aktet e tjera nënligjore.
Licencë për furnizimin e energjisë elektrike	Një autorizim që i jepet një personi, sipas përcaktimeve në pjesën e tretë të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike për të kryer veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike të klientëve tariforë.
Aktiviteti i licencuar	Aktivitete të nevojshme me qëllim furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve brenda territorit të autorizuar me tarifa të rregulluara.
Tarifë e rregulluar	Një tarifë në fuqi e aprovuar nga ERE në bazë të legjislacionit në fuqi dhe rregulloreve e rregullave të ERE-s.

I licencuari	Personi që ka licencën sipas përcaktimeve në pjesën e tretë të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.
Personi	“Personi” do të thotë çdo person fizik ose juridik.
Rregulloret dhe rregullat	Standardet, kodet, rregulloret, urdhrat, vendimet dhe rekomandime të tjera në fuqi të miratuara nga ERE.
Kodi i Sistemit të Transmetimit	Kodi i Sistemit të Transmetimit është një dokument që përcakton kufijtë, marrëdhëniet ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesve, dhe vendos procedurat për operimin dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit, në përputhje me zhvillimin e tregut shqiptar dhe rajonal të energjisë elektrike.
Kodi i Funksionimit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike	Është tërësia e rregullave teknike, që rregullojnë funksionimin e rrjetit të shpërndarjes dhe që vendosin kushtet dhe termat e shërbimit të shoqërive të shpërndarjes për konsumatorët.
Kodi i Matjes së KMEE Energjisë Elektrike	përcakton kërkesat minimale teknike të ndërtimit dhe shfrytëzimit të sistemit të matjes së energjisë elektrike, i cili do të jetë i përshtatshëm për matjen, regjistrimin, mbledhjen e të dhënave dhe zbatimin e procedurave përkatëse sipas rregullave të tregut të energjisë elektrike, marrëveshjeve midis palëve dhe legjislacionit në fuqi.
Rregullat e tregut	Janë rregullat e veprimit dhe menaxhimit të tregut, si dhe marrëdhënieve tregtare ndërmjet mbajtësve të licencës.
Pagesë rregullimi	Pagesat vjetore të vendosura nga ERE, për veprimtaritë e licencuara që janë objekt i rregullimit.
Metodologjia e llogaritjes së tarifave dhe të shërbimit të transmetimit dhe shpërndarjes	Procedurat për llogaritjen e tarifave (TPRSH) dhe TRPT të vendosura ndaj të licencuarit për përdorimin e faciliteteve SSH dhe ST.
Gjenerues	Një person i licencuar nga ERE për prodhimin e energjisë elektrike.
Transferimi	Transferim do të thotë çdo shitje, qira, peng, shkëmbim ose çdo formë tjetër disponimi, i plotë ose i pjesshëm, i së drejtës për t'u angazhuar në aktivitetin e licencuar.
Operatori i sistemit të transmetimit (OST)	Personi i licencuar përgjegjës për aktivitetet e transmetimit dhe dispeçerimit dhe për procesin e kontrollit të operimit të centraleve prodhuese e elektrike dhe faciliteteve të tjera të industrisë së energjisë elektrike dhe burimet për të siguruar

stabilitetin, sigurinë, qëndrueshmërinë dhe operimin eficient të sistemit elektroenergjetik.

Marrëveshje

Kontratë e nënshkruar për shitblerjen e energjisë elektrike e lidhur midis një të licencuari dhe një furnizuesi.

2. Kushtet për kryerjen e aktivitetit të licencuar

2.1 I licencuari autorizohet nga kjo licencë për të ushtruar aktivitetin e licencuar vetëm brenda kufijve të zonës gjeografikisht të përcaktuar në aneksin A, bashkëlidhur kësaj licencë.

2.2 I licencuari nuk do të bashkëpunojë në asnjë mënyrë me të licencuar të tjerë për përgatitjen dhe negocimin e çështjeve të ERE-s, që lidhen ose ndikojnë në tarifat e energjisë elektrike ose për pagesa të tjera të aplikuara mbi konsumatorët, me përjashtim nga sa mund të lejohet shprehimisht nga legjislacioni në fuqi ose rregulloret dhe rregullat, dhe nuk do të bashkëpunojë në ndonjë mënyrë tjetër lidhur me aktivitetin e licencuar për të dëmtuar furnizuesit ose konsumatorët ekzistues ose potencialë.

2.3 I licencuari nuk do të angazhohet në ndër-subvencionime. Nëse i licencuari është një kompani vertikalisht e integruar, do t'i ndajë llogaritë e tij financiare sipas aktiviteteve të prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes brenda afatit të kërkuar nga legjislacioni në fuqi në mënyrë të mjaftueshme, për të mundësuar që ERE të konkludojë se nuk ka ndër-subvencionime, aktivitete antikonkurrencë ose diskriminim.

2.4 I licencuari nuk do të angazhohet në asnjë formë aktiviteti monopol ose antikonkurrencë të ndaluar nga legjislacioni në fuqi dhe rregulloret e rregullat e miratuara nga ERE.

2.5 I licencuari do ta kryejë aktivitetin e licencuar, në përputhje me parimet e efikasitetit ekonomike dhe objektivin e arritjes së kostos më të ulët.

2.6 I licencuari nuk do të angazhohet në aktivitete të tjera, në sektorë që pengojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen e aktivitetit të licencuar. I licencuari do të informojë ERE-n para se të ndërmarrë ndonjë aktivitet, përveç aktivitetit të licencuar. ERE mund ta ndalojë të licencuarin të kryejë çdo aktivitet, përveç aktivitetit të licencuar, ose mund të vendosë kushte për kryerjen e këtij aktiviteti, të nevojshme këto për të mbrojtur konsumatorët.

2.7 I licencuari do të informojë ERE-n për ngritjen e çdo biznesi shoqëruar. ERE mund të ndalojë ose të imponojë kushte për ngritjen e biznesit shoqëruar, të nevojshme këto për të mbrojtur konsumatorët e Republikës së Shqipërisë.

2.8 I licencuari nuk do të pengojë, parandalojë ose të përpikët të parandalojë të licencuarit e tjerë ose konkurrentët potencialë që të angazhohen ose të hyjnë në mënyrë të ligjshme në biznesin e sektorit të energjisë elektrike në Republikën e Shqipërisë.

3. Detyrimet e të licencuarit

3.1 I licencuari do të zbatojë legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e rregullat e miratuara nga ERE.

3.2 I licencuari do të jetë përgjegjës për planifikimin dhe sigurimin e energjisë elektrike të nevojshme për furnizimin e klientëve tariforë që mbulon.

3.3 I licencuari duhet të fillojë aktivitetin brenda 45 ditëve nga marrja e licencës, në të kundërt kjo licencë e humbet fuqinë juridike.

3.4 Brenda 15 ditëve nga marrja e licencës, i licencuari do të depozitojë në formën e garancisë bankare, një shumë që garanton vazhdimësinë e kryerjes pa ndërprerje të aktivitetit.

3.5 Pavarësisht nga forma në të cilën është bërë garancia financiare, ajo nuk do të jetë në asnjë çast më pak se shuma e nevojshme për kryerjen e kontratës në funksion të 30 ditëve kalendarike.

3.6 I licencuari do të lidhë marrëveshje për blerjen e energjisë elektrike me kompaninë gjeneruese ose importuesit për furnizimin e klientëve tariforë.

3.7 Shitja e energjisë elektrike për klientët tariforë do të bëhet në përputhje me “kontratën e furnizimit të energjisë elektrike” të miratuar nga ERE dhe me çmime të rregulluara.

3.8 I licencuari do të lidhë marrëveshje për kryerjen e shërbimit të transmetimit dhe shpërndarjes së Energjisë elektrike dhe shërbimeve ndihmëse përkatësisht me OST dhe DDC.

3.9 I licencuari do të respektojë kërkesat e parashikuara në Kodin e Matjes të miratuar nga ERE për çështjet e matjes së energjisë elektrike, leximit, shqyrtimit dhe transmetimit të të dhënave të matësit elektrik, parandalimit të vjedhjes së energjisë elektrike, cilësisë së shërbimit dhe informacionit për konsumatorët.

4. Llogaritë dhe raportimi

4.1 I licencuari do të mbajë për aktivitetin e licencuar llogari të ndara nga aktivitetet e tjera, në

përputhje me nenet 23 dhe 33 të ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

4.2 Të licencuarit i kërkohet të përgatisë dhe të dorëzojë në ERE brenda datës 31 mars të vitit nga marrja e licencës, si dhe në çdo kohë brenda një afati të caktuar, kur çmohet e domosdoshme nga ERE, një raport vjetor lidhur me veprimtarinë e tij në vitin kalendarik të mëparshëm që të përmbajë sa më poshtë:

- a) një përmbledhje dhe analizë të aktivitetit furnizues të të licencuarit;
- b) shitjet e energjisë elektrike dhe të dhënat për mbledhjen e faturave gjatë vitit;
- c) cilësinë e shërbimit të furnizimit dhe detajet e çdo mase të marrë për përmirësimin e shërbimit të furnizimit në zonë;
- d) çdo ndërprerje të energjisë elektrike;
- e) një përmbledhje dhe analizë të kontratave të lidhura për shitblerjen e energjisë elektrike që janë në fuqi gjatë vitit që raportohet;
- f) tabelën e treguesve të performancës siç përcaktohet në Kodin e Shpërndarjes.

4.3 Të licencuarit mund t’i kërkohet të bëjë publik informacionin e mësipërm të dërguar në ERE, kur ky informacion konsiderohet nga ERE me interes për konsumatorin. Përgjashtimisht publikimi nuk do të kërkohet në rastet kur:

- a) me kërkesë të të licencuarit, ERE vendos që përmbushja e interesit publik nga publikimi i informacionit nuk justifikon dëmin e mundshëm tregtar ndaj të licencuarit;
- b) informacioni është sekret shtetëror.

4.4 I licencuari është i detyruar të informojë ERE-n për çdo konflikt të kushteve të licencës së tij brenda 7 ditë-pune nga konstatimi i konfliktit nga i licencuari.

4.5 I licencuari do t’i dorëzojë ERE-s, me kërkesën e këtij të fundit, në formën dhe brenda afatit të vendosur nga ERE, çdo informacion të nevojshëm për ERE-n.

4.6 I licencuari do të ndajë shpenzimet e përbashkëta mes aktivitetit të tij të licencuar dhe aktiviteve të tjera (përfshirë dhe ato të licencuara) në baza të arsyeshme, në përputhje me paragrafët 4.1 dhe 4.2 të kësaj licence dhe praktikat e biznesit përgjithësisht të pranura. I licencuari do t’i paraqesë ERE-s dokumentacionin që paraqet bazat për ndarjen e shpenzimeve të përbashkëta, si dhe rezultatet e arritura.

4.7 I licencuari do ta njoftojë ERE-n, brenda 10 ditëve për çdo ndryshim të:

- a) adresës;
- b) statutit të të licencuarit;
- c) certifikatës së regjistrimit;
- d) kodit fiskal;
- e) menaxherit kryesor.

4.8 Nëse i licencuari parashikon një situatë emergjence, siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi, i licencuari do të njoftojë pa vonesë ERE-n dhe ky njoftim do të përshkruajë çfarë masash do të marrë i licencuari për të parandaluar ose përmirësuar ndikimet e situatës së emergjencës së parashikuar.

4.9 Gjithë njoftimet zyrtare, aplikimet, peticionet dhe deklaratat lidhur me licencën duhet të jenë me shkrim.

5. Përdorimi i informacionit

5.1 I licencuari do të sigurojë që çdo informacion i marrë nga të tjerë si rezultat i aktivitetit të tij të licencuar nuk do t’i jepet askujt, me përjashtim të rasteve kur:

- a) jepet pëlqimi paraprak me shkrim i personit me të cilin lidhet informacioni;
- b) informacioni është bërë publik;
- c) të licencuarit i kërkohet ose i lejohet ta përhapë informacionin për të përmbushur kushtet e kësaj licence, një urdhër të ERE-s ose çdo dispozitë ligjore të aplikueshme.

5.2 I licencuari do të sigurojë që bizneset shoqëruese nuk do të përdorin asnjë informacion që disponon i licencuari për të fituar një avantazh konkurrues të pajustificuar, dhe do të sigurojë që nuk do ta përhapin informacionin tek asnjë person tjetër (përfshirë ata të një biznesi tjetër shoqërues), gjë që mund ta mundësojë këtë person të fitojë çdo lloj avantazhi komercial të pajustificuar.

5.3 Informacioni i dërguar ERE-s nga i licencuari do të konsiderohet publik me përjashtim të rasteve kur me kërkesë specifike të të licencuarit, ERE me vendim përcakton që ky informacion është i natyrës pronësore dhe se interesi publik i shërbyer nga përhapja e informacionit nuk do ta justifikojë ose kompensojë dëmin potencial komercial që i shkaktohet të licencuarit.

5.4 I licencuari do të respektojë rregulloret dhe rregullat e aplikueshme të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe kompanive shpërndarëse të aprovuara nga ERE, përfshirë kryerjen e gjithë urdhrave operative, instruksioneve ose udhëzimeve dhe dorëzimin e informacionit teknik dhe gjithë dokumentacionit tjetër të kërkuar.

6. Pagesat e rregullimit

6.1 I licencuari do të paguajë pagesa rregullimi në mënyrë të rregullt e të vazhdueshme gjatë afatit të kësaj licence siç përcaktohet nga ERE, në përputhje me nenin 12 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe rregulloret e aplikueshme të ERE-s.

6.2 Nëse i licencuari nuk i paguan ERE-s pagesat e rregullimit sipas paragrafit 6.1 brenda afatit të kërkuar nga ERE, i licencuari do të penalizohet në përputhje me nenin 64 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

7. Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes dhe transmetimit

Tarifat TPRSH dhe TPRT do të rregullohen dhe aprovohen nga ERE, në përputhje me metodologjitë përkatëse të miratuara nga ERE.

8. Kontrolli mbi kryerjen e aktivitetit të licencuar

8.1 ERE do monitorojë zbatimin nga i licencuari të kushteve të licencimit, do të shqyrtojë raportet e marra nga i licencuari dhe, në çdo kohë, është e autorizuar të inspektojë librat e llogarive të të licencuarit dhe mund të kërkojë një auditim teknik dhe/ose kontabël të aktiviteteve të të licencuarit.

8.2 Përfaqësues të autorizuar të ERE-s kanë të drejtë të inspektojnë dhe të kontrollojnë ambientet e të licencuarit, pajisjet dhe dokumentet e tij për të verifikuar kryerjen e aktivitetit të licencuar në përputhje me kushtet e licencës, si dhe rregulloret dhe rregullat e ERE-s. I licencuari do të sigurojë çdo ndihmë të kërkuar, të nevojshme për ERE-n gjatë këtij inspektimi.

8.3 Në bazë të ankesës së vërtetuar të çdo pale të tretë ose në bazë të propozimit të nisur kryesisht nga ERE, ky i fundit mund të nisë një hetim mbi zbatimin nga i licencuari të kushteve të licencës së tij ose rregulloreve dhe rregullave të ERE-s.

8.4 I licencuari do të informojë ERE-n, duke dhënë shpjegimet dhe arsyet për çdo shkelje të këtyre kushteve të licencës brenda një jave që kjo shkelje i bëhet e njohur të licencuarit.

8.5 I licencuari do t’u bindet vendimeve të marra nga ERE, përfshirë pagesën e gjobave të vendosura nga ERE në përputhje me legjislacionin në fuqi, rregulloret dhe rregullat e ERE-s dhe kushtet e kësaj licence.

9. Amendamenti i licencës

9.1 ERE mund të amendojë kushtet e licencës, në rast se ato nuk përputhen me:

a) Legjislacionin në fuqi dhe vendimet e Qeverisë së Republikës të Shqipërisë që janë në përputhje me legjislacionin në fuqi;

b) Vendimet e formës së prerë të gjykatave të Republikës së Shqipërisë.

9.2 Në çdo kohë i licencuari ose ERE mund të propozojnë amendamente të tjera për këto kushte licence, përveç atyre të specifikuara në paragrafin 9.1 duke i transmetuar një propozim me shkrim, së bashku me çdo dokument mbështetës, palës tjetër.

9.3 ERE do të marrë vendimin përfundimtar vetëm pasi të marrë në konsideratë interesat e konsumatorëve dhe të licencuarve të tjerë. Palët e interesuara do të informohen me shkrim për çdo amendament të propozuar. Nëse ERE dhe i licencuari arrijnë një marrëveshje për këto amendamente, kushtet e licencës do të amendohen. Nëse marrëveshja nuk arrihet, i licencuari mund të apelojë në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë.

10. Heqja e licencës

10.1 ERE mund ta heqë licencën, në përputhje me ligjin nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe rregulloret e miratuara nga ERE, kur:

a) i licencuari kërkon revokimin e licencës;

b) i licencuari shkel kushtet e licencës dhe nuk përmbush një ose disa nga detyrimet e shprehura në këtë licencë;

c) i licencuari shkel legjislacionin në fuqi;

d) i licencuari deklarohej i falimentuar dhe është i paaftë të përmbushë detyrimet e kushteve të licencës;

e) i licencuari ka marrë licencë duke mashtruar.

10.2 Nëse i licencuari ndryshon statusin e tij ligjor ose nëse aksionari që kontrollon interesat ndryshohet pa autorizimin e ERE-s, licenca bëhet nul (e pavlefshme) dhe anulohet dhe pasuesi i të licencuarit do të aplikojë për një licencë të re, në përputhje me procedurat e ERE-s për dhënie licence.

11. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe e drejta për apelim

11.1 Çdo çështje e diskutueshme ose kërkesë mes të licencuarit dhe çdo përdoruesi të sistemit të transmetimit lidhur me aktivitetin dispeçerues ose kushtet e licencës do të zgjidhet sa më shumë që të jetë e mundur me mirëkuptim, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e rregullat e ERE-s.

11.2 Nëse zgjidhja nuk arrihet me mirëkuptim, atëherë ERE në bazë të peticionit të çdo personi që është palë në këtë mosmarrëveshje do ta zgjidhë mosmarrëveshjen dhe do të nxjerrë vendimin e tij në

përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e rregullat e saj.

11.3 I licencuari mund të apelojë kundër vendimeve të ERE-s në gjykatë brenda 30 ditëve nga botimi i vendimit në Fletoren Zyrtare, sipas nenit 9 pika 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

11.4 I licencuari do t’u bindet vendimeve të përkohshme të ERE-s në pritje të apelimit në gjykatë.

Republika e Shqipërisë
Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike

LICENCË
PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE
TË KLIENTËVE TARIFORË

Licenca i jepet:

Seria:

Numri i licencës:

Data e hyrjes në fuqi të këtij aneksi:

ANEKSI A
TERRITORI I AUTORIZUAR PËR AKTIVITETIN E LICENCUAR

ëI licencuari _____, autorizohet të ushtrojë aktivitetin e furnizimit me energji elektrike të klientëve tariforë në territorin e _____ Republikës së Shqipërisë]

VENDIM
Nr.58, datë 14.10.2005

PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA SHOQËRIA
“ESSEGEI – SHQIPËRI - SMOKTHINË” SHPK PËR PERIUDHËN 1.05.2004 – 31.12.2004.

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa b, 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe vendimit nr.60, datë 29.12.2005 të Bordit të Komisionerëve “Për miratimin e të dhënave bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël”, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 14.10.2005, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Essegei-Shqipëri-Smokthinë” sh.p.k., për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për HEC-in Smokthinë,

VENDOSI :

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga shoqëria “Essegei-Shqipëri Smokthinë” sh.p.k., për HEC-in Smokthinë, për periudhën 1.5.2004-31.12.2004, të jetë 4.5 lekë/kWh.
2. Ngarkohet shoqëria “Essegei-Shqipëri-Smokthinë” sh.p.k. dhe KESH sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr.59, datë 14.10.2005

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA SHOQËRIA
“ESSEGEI – SHQIPËRI - SMOKTHINË” SHPK PËR VITIN 2005**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa b, 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike ” dhe vendimit nr.60, datë 29.12.2005 të Bordit të Komisionerëve “Për miratimin e të dhënave bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël”, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 14.10.2005, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Essegei-Shqipëri-Smokthinë” sh.p.k., për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për HEC-in Smokthinë,

VENDOSI:

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga shoqëria “Essegei-Shqipëri-Smokthinë” sh.p.k., për HEC-in Smokthinë, për periudhën 1.1.2005-31.12.2005, të jetë 5.4 lekë/kWh.

2. Ngarkohet shoqëria “Essegei-Shqipëri-Smokthinë” sh.p.k. dhe KESH sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema**

**VENDIM
Nr.61, datë 25.10.2005**

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 26, pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s,” me ndryshimet përkatëse, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.10.2005, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Hydroelectric Company of Albania” sh.p.k., për përcaktimin e çmimit të energjisë elektrike për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2005,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për përcaktimin e çmimit të energjisë elektrike për shoqërinë “Hydroelectric Company of Albania” sh.p.k., për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2005.

2. Ngarkohet Departamenti i Tarifave dhe i Çmimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema**

**VENDIM
Nr.67, datë 4.11.2005**

**PËR MIRATIMIN E LICENCËS SË FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR PËR FURNIZIMIN E
ENERGJISË ELEKTRIKE TË KLIENTËVE TË KUALIFIKUAR**

Mbështetur në nenet 9 dhe 13, germa ç të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.11.2005, pasi shqyrtoi draftin e paraqitur nga Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për licencën e furnizuesit të kualifikuar për furnizimin e energjisë elektrike të klientëve të kualifikuar,

VENDOS:

1. Miratimin e licencës së furnizuesit të kualifikuar për furnizimin e energjisë elektrike të klientëve të kualifikuar, bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S

Pjetër Dema

Republika e Shqipërisë
Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike

LICENCË E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR
PËR FURNIZIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE TË KLIENTËVE TË KUALIFIKUAR

Seria: _____ Numri i licencës: _____
Data e hyrjes në fuqi: _____
Licenca i jepet: _____
Shoqëria: _____
Kodi fiskal: _____
Certifikata e regjistrimit: _____

Bazuar në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, me vendim të Bordit të Komisionerëve nr.____, datë _____, Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike (“ERE”) i jep licencën e furnizuesit të kualifikuar për furnizimin me energji elektrike të klientëve të kualifikuar, subjektit _____. Kjo licencë është në fuqi për periudhën nga ____ deri më _____, në rast se nuk hiqet nga ERE, në përputhje me kushtet e licencës.

KRYETARI I ERE-S

Pjetër Dema

Republika e Shqipërisë
Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike

KUSHTET E LICENCËS PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE
TË KLIENTËVE TË KUALIFIKUAR

Seria: _____ Numri i licencës: _____

I jepet : _____
(Emri i plotë i të licencuarit)

1. Dispozita të përgjithshme

1.1 ERE është autoriteti i vetëm në Republikën e Shqipërisë, i njohur sipas pjesës së tretë të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, për të lëshuar dhe deklaruar hyrjen në fuqi të kësaj licence.

1.2 Nëse ndonjë kusht i kësaj licence shfuqizohet, ky kusht do të fshihet nga kushtet e licencës, dhe kushtet e mbetura të licencës do të vazhdojnë të jenë plotësisht në fuqi.

1.3 Kjo licencë nuk mund të transferohet, tërësisht ose pjesërisht, tek asnjë person tjetër pa vendim të veçantë me shkrim të ERE-s. Kur aprovon një transferim, ERE mund ta ndryshojë periudhën e licencës ose kushtet e tjera të licencës, pasi të parashtrijë një shkak të arsyeshëm.

1.4 ERE ka të drejtën ekskluzive për ta ndryshuar atë në rast se kushtet dhe rrethanat kanë ndryshuar. ERE rezervon në mënyrë specifike të drejtën për ta ndryshuar këtë licencë për përputhjen e saj

me dispozitat e Kodit të Transmetimit, Kodit të Shpërndarjes, Kodit të Matjes dhe rregullave të tregut të miratuara nga ana e saj në bazë të legjislacionit në fuqi.

1.5 Fjalët dhe frazat e mëposhtme të përdorura në licencë, kushtet e licencës dhe anekset, kur përdoren, do të kenë kuptimet e mëposhtme:

Shërbimet ndihmëse	Shërbimet e kërkuara për të ruajtur standarde të përcaktuara të sigurisë dhe të cilësisë së energjisë elektrike. Shërbimet ndihmëse përfshijnë: - Kompensimin e energjisë reaktive nga përdoruesit për të ruajtur nivelet standarde të tensionit dhe ulur humbjet në rrjet. - Rregullimin fuqi aktive frekuencë, si dhe rezervat e lidhura me të. - Kompensimin e angazhimeve dhe alokimin e kapaciteteve në linjat e interkonjeksionit.
Biznesi shoqërues	Çdo biznes tjetër që direkt ose indirekt, tërësisht ose pjesërisht: 1. është pronë e të licencuarit; 2. ka të licencuarin pronë; 3. është në pronësi të një personi, i cili është pronë e të licencuarit.
Territori i autorizuar	Rajon gjeografikisht i kufizuar, i specifikuar në aneksin A të licencës, brenda të cilit furnizuesi i kualifikuar është i autorizuar të kryejë aktivitetin e licencuar.
Tarifa e përdorimit të rrjetit shpërndarës nga furnizuesi i kualifikuar (TPRSH)	Pagesa që furnizuesi i kualifikuar paguan për përdorimin e faciliteteve të rrjetit shpërndarës, për shpërndarje të energjisë elektrike te klientët e kualifikuar, që aprovohet nga ERE herë pas here
Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit nga furnizuesi i kualifikuar (TPRT)	Pagesa që furnizuesi i kualifikuar paguan për përdorimin e faciliteteve të rrjetit të transmetimit, për transmetim të energjisë elektrike te klientët e kualifikuar, që aprovohet nga ERE herë pas here
Ndër-subvencionimet	Transferim fondesh ose ndarje kostosh brenda llogarive të të licencuarit ose në mes bizneseve shoqëruese për mbështetje financiare të një aktiviteti ose biznesi me koston e një tjetri.
Shpërndarja	Është transporti i energjisë elektrike në sistemet shpërndarëse të tensionit të mesëm dhe të ulët, duke pasur parasysh shpërndarjen te konsumatori fundor.
Sistemi i shpërndarjes (SSH)	Sistemi i shpërndarjes përfshin zbarat, pajisjet kyçëse/shkyçëse dhe transformatorët në nënstacionet 110/35/20/10 kV, si dhe të gjitha elementet në nivel tensioni më të ulët se 110 kV në pronësi të kompanisë së shpërndarjes.
Sistemi i transmetimit (ST)	Sistemi i transmetimit të energjisë elektrike përbëhet nga bashkësi linjash elektrike të tensionit të lartë (110 kV, 150 kV, 220 kV, 400 kV), stacione transformuese elektrike ose çdo instalim tjetër, funksioni i të cilave përfshin transmetimin ose interkonjeksionin ndërkombëtar.
Energjia elektrike aktive	Energjia elektrike aktive është fuqia aktive që gjenerohet apo kalon në një qark elektrik gjatë një intervali kohe, duke qenë integrali i caktuar i fuqisë

	aktive me kufij kohorë. Matet me njësi vat-orë ose shumëzime standarde: 1000 Wh = 1 KWh 1000 KWh = 1 MWh 1000 MWh = 1 GWh 1000 GWh = 1 TWh = 10¹²Wh.
Energjia elektrike reaktive (Varh)	Energjia elektrike reaktive është integrali i caktuar me kufij kohorë i fuqisë reaktive matur në njësi me volt-amper reaktive-orë ose shumëzime standarde që është: 1000 Varh = 1 kVArh 1000 kVArh = 1 MVarh 1000 MVarh = 1 GVarh 1000 GVarh = 1 TVArh=10¹²Var
Klient i kualifikuar	Një konsumator që ka të drejtën sipas legjislacionit në fuqi ose rregulloreve të aplikueshme të ERE-s, të zgjedhë furnizuesin e energjisë elektrike për energjinë elektrike të përdorur për nevojat e tij.
ERE	Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike, që vepron sipas ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.
Legjislacioni në fuqi	Ligjet e Republikës së Shqipërisë të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë dhe aktualisht në fuqi, si dhe të gjitha aktet e tjera nënligjore.
Licencë për furnizimin e energjisë elektrike të klientëve të kualifikuar	Një autorizim që i jepet një personi, sipas përcaktimeve në pjesën e tretë të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” për të kryer veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike të klientëve të kualifikuar.
Aktiviteti i licencuar	Aktivitete të nevojshme me qëllim furnizimin me energji elektrike brenda territorit të autorizuar me tarifa të parregulluara të klientëve të kualifikuar.
I licencuari	Personi që ka licencën sipas përcaktimeve në pjesën e tretë të ligjit nr.9072 , datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.
Personi	“Personi” do të thotë çdo person fizik ose juridik.
Tarifa e rregulluar	Një tarifë aktualisht në fuqi e aprovuar nga ERE, në bazë të legjislacionit në fuqi dhe rregulloreve dhe rregullave të ERE-s.
Rregulloret dhe rregullat	Standardet, kodet, rregulloret, urdhrat, vendimet dhe rekomandime të tjera në fuqi të miratuara nga ERE.
Kodi i Sistemit të Transmetimit	Kodi i Sistemit të Transmetimit është një dokument që përcakton kufijtë, marrëdhëniet ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesve dhe vendos procedurat për operimin dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit në përputhje me zhvillimin e tregut shqiptar dhe rajonal të energjisë elektrike.
Kodi i Funkcionimit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike	Është tërësia e rregullave teknike, që rregullojnë funksionimin e rrjetit të shpërndarjes dhe që vendosin kushtet dhe termat e shërbimit të shoqërive të shpërndarjes për konsumatorët.
Kodi i Matjes së	KMEE përcakton kërkesat minimale teknike të ndërtimit dhe shfrytëzimit

Energjisë Elektrike	të sistemit të matjes së energjisë elektrike, i cili do të jetë i përshtatshëm për matjen, regjistrimin, mbledhjen e të dhënave dhe zbatimin e procedurave përkatëse sipas rregullave të tregut të energjisë elektrike, marrëveshjeve midis palëve dhe legjislacionit në fuqi.
Rregullat e tregut	Janë rregullat e veprimit dhe menaxhimit të tregut, si dhe marrëdhëniet tregtare ndërmjet mbajtësve të licencës.
Pagesë rregullimi	Pagesat vjetore të vendosura nga ERE, për veprimtaritë e licencuara që janë objekt i rregullimit.
Metodologjia e llogaritjes së tarifave të shërbimit të transmetimit dhe shpërndarjes	Procedurat për llogaritjen e tarifave (TPRSH) të vendosura ndaj të licencuarit për lidhjen me facilitetet e SSH dhe ST.
Gjenerues	Një person i licencuar nga ERE për prodhimin e energjisë elektrike.
Transferimi	Transferim do të thotë çdo shitje, qira, peng, shkëmbim ose çdo formë tjetër disponimi, i plotë ose i pjesshëm, i së drejtës për t'u angazhuar në aktivitetin e licencuar.
Operatori i sistemit të transmetimit (OST)	Personi i licencuar përgjegjës për aktivitetet e transmetimit dhe dispeçerimit dhe për procesin e kontrollit të operimit të centraleve prodhuese elektrike dhe faciliteteve të tjera të industrisë së energjisë elektrike, dhe burimet për të siguruar stabilitetin, sigurinë, qëndrueshmërinë dhe operimin eficient të sistemit elektroenergjetik.

2. Kryerja e aktivitetit të licencuar

2.1 I licencuari, që në vijim do të quhet furnizuesi i kualifikuar, autorizohet nga kjo licencë për të ushtruar aktivitetin e licencuar në territorin e Republikës së Shqipërisë, për furnizimin e klientëve të kualifikuar.

2.2 Furnizuesi i kualifikuar do ta kryejë aktivitetin e licencuar në përputhje me parimet e efijencës ekonomike dhe objektivin e arritjes së kostos më të ulët.

2.3 Furnizuesi i kualifikuar nuk do të angazhohet në aktivitete të tjera, që pengojnë ose mund të pengojnë kryerjen e duhur të aktivitetit të licencuar. Furnizuesi i kualifikuar do të informojë ERE-n para se të ndërmarrë ndonjë aktivitet në sektorin e energjisë elektrike, përveç aktivitetit të licencuar. ERE mund ta ndalojë të licencuarin të kryejë çdo aktivitet në sektorin e energjisë elektrike, përveç aktivitetit të licencuar, ose mund të vendosë kushte për kryerjen e këtij aktiviteti, të nevojshme këto për të mbrojtur klientin e kualifikuar.

2.4 Furnizuesi i kualifikuar do të informojë ERE-n për ngritjen e çdo biznesi shoqëruar. Në rast se ERE vlerëson se ngritja e këtij biznesi dëmton klientët, mund të vendosë për furnizuesin e kualifikuar kushte të tjera në licencë sipas rastit të paraqitur.

2.5 Furnizuesi i kualifikuar nuk do të pengojë, parandalojë ose të përpiqet të parandalojë të licencuarit e tjerë ose konkurrentët potencialë që të angazhohen ose të hyjnë në mënyrë të ligjshme në biznesin e sektorit të energjisë elektrike në Republikën e Shqipërisë.

3. Detyrimet e të licencuarit

3.1 Furnizuesi i kualifikuar do të zbatojë legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e rregullat e miratuara nga ERE.

3.2 Furnizuesi i kualifikuar duhet të fillojë aktivitetin brenda 1 viti nga marrja e licencës, në të kundërt kjo licencë e humbet fuqinë juridike.

3.3 Brenda 15 ditëve nga fillimi i aktivitetit, furnizuesi i kualifikuar do të depozitojë në formën e garancisë bankare, një shumë që garanton vazhdimësinë e kryerjes pa ndërprerje të aktivitetit.

3.4 Pavarësisht nga forma në të cilën është bërë garancia financiare, ajo nuk do të jetë në asnjë çast më pak se shumta e nevojshme për kryerjen e kontratës me klientin e kualifikuar në funksion të 30 ditëve kalendarike.

3.5 Marrëdhëniet e furnizuesit të kualifikuar dhe klientit të kualifikuar do të rregullohen në

përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi .

4. Detyrimet për matjen

4.1 Furnizuesi i kualifikuar nuk do ta furnizojë me energji elektrike klientin e kualifikuar pa pajisjen me një sistem matës elektrik për qëllime faturimi, i cili do të plotësojë të gjitha kushtet e përcaktuara nga ligjet dhe normat në fuqi.

4.2 Furnizuesi i kualifikuar do të sigurojë që të gjithë komponentët e sistemit matës elektrik të jenë të vulosur sipas përcaktimeve të bëra në Kodin e Matjes.

4.3 Furnizuesi i kualifikuar do të verifikojë dhe mirëmbajë periodikisht sistemin e matjes së energjisë elektrike duke ndjekur programin e caktuar nga rregulloret në fuqi për matjet, ose në çdo kohë kur është e nevojshme. Furnizuesi i kualifikuar do të jetë përgjegjës për të gjitha shpenzimet që kanë të bëjnë me vënien në vend ose zëvendësimet, përveç rasteve ku është konstatuar që kjo është për faj të klientit të kualifikuar ose sipas marrëveshjes të bërë mes palëve

4.4 Kur ka njoftime me shkrim nga konsumatori për prishjen e pajisjes matëse ose për ndonjë gabim në leximin e matësit, furnizuesi i kualifikuar do të sigurojë verifikimin e pajisjes nëpërmjet një laboratorit matjeje të autorizuar ose certifikuar, ose me marrëveshje, dhe në praninë e konsumatorit do të bëjë verifikimin në vendin ku është instaluar. Furnizuesi i kualifikuar do të rivendosë me shpenzimet e tij vetjake, matësin e gjendur me gabime jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data kur është regjistruar njoftimi me shkrim i konsumatorit.

4.5 Furnizuesi i kualifikuar do të mbajë një sistem evidentimi për vlerësimin e sasisë së energjisë elektrike të konsumuar nga konsumatorët për të cilët leximet aktuale të matësve nuk janë të rregullta; në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e miratuara nga ERE.

4.6 Furnizuesi i kualifikuar do të përcaktojë konsumin për çdo orë të energjisë elektrike për konsumatorët e kualifikuar të furnizuar prej tij nëpërmjet matjes, vlerësimit të ngarkesës orare të konsumit ose nëpërmjet çdo metode tjetër të pranueshme nga palët.

4.7 Furnizuesi i kualifikuar do të marrë aprovimin nga ERE për metodat dhe procedurat e përdorura për të përcaktuar dhe vlerësuar konsumin e energjisë elektrike.

5. Leximi, shqyrtimi dhe transmetimi i të dhënave të matësit elektrik

5.1 Furnizuesi i kualifikuar pas leximit mujor të matësve në çdo klient të kualifikuar dhe faturimit përkatës të kësaj sasive energjie, do të dërgojë çdo muaj tek operatori i sistemit të transmetimit sipas rregullave në fuqi, të dhëna lidhur me vlerën e konsumit të energjisë elektrike të të gjithë klientëve të kualifikuar që furnizohen nga furnizuesi i kualifikuar.

5.2 Furnizuesi i kualifikuar do të bëjë leximin orar të matësit dhe do të informojë OST-në për këtë lexim kur kërkohet, dhe çdo muaj.

6. Parandalimi i vjedhjes së energjisë elektrike dhe dëmtimit të matësve dhe ndërhyrjeve

6.1 Furnizuesi i kualifikuar merr masa që janë praktikisht të arsyeshme për të parandaluar dhe zbuluar:

- a) Vjedhjen e energjisë nga konsumatori i furnizuar ose konsumatorë të tjerë.
- b) Dëmtimin e pajisjeve ose matësve që përdoren për furnizimin me energji të konsumatorit.
- c) Ndërhyrjen në matës elektrikë të furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve.

6.2 Brenda 24 orëve të incidentit të zbuluar, furnizuesi i kualifikuar do të informojë kompaninë e shpërndarjes/operatorin e transmetimit të prekur rreth ndonjë incidenti, i cili në opinionin e tij mund të ketë shkaktuar dëmtime në pajisjet elektrike.

6.3 Furnizuesi i kualifikuar do të informojë operatorët e rrjetit për ndonjë incident të shkaktuar me dashje nga ndonjë person ose të pranisë, ose përdorimit të lidhjes jolegale me rrjetin për të lejuar hetimin e incidentit dhe zgjidhjen e problemeve të sigurimit që lidhen me të.

6.4 Furnizuesi i kualifikuar do të informojë operatorët e rrjetit për planifikimin e veprimeve të tij që kanë të bëjnë me parandalimin e aktiviteteve jolegale dhe do të specifikojë rrethanat ku ai mund të kërkojë për shkyçje (zgjidhje) të konsumatorit të gjetur fajtor.

7. Cilësia e shërbimit

7.1 Furnizuesi i kualifikuar do ta ndërtojë dhe zhvillojë veprimtarinë e tij në përputhje me kodet e rrjetit dhe shpërndarjes për të plotësuar treguesit e cilësisë dhe performancës.

7.2 Furnizuesi i kualifikuar është përgjegjës për mosrealizimin e shërbimit në përputhje me treguesit e cilësisë të përcaktuara në planin e menaxhimit dhe në Kodin e Sistemit të Shpërndarjes.

8. Llogaritë dhe raportimi

8.1 Furnizuesi i kualifikuar do të mbajë për aktivitetin e licencuar llogari të ndara nga aktivitetet e tjera në përputhje me nenet 23 dhe 33 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

8.2 Të licencuarit i kërkohet të përgatisë dhe të dorëzojë në ERE brenda datës 31 mars të vitit, nga marrja e licencës, si dhe në çdo kohë brenda një afati të caktuar, kur çmohet e domosdoshme nga ERE, një raport vjetor lidhur me veprimtarinë e tij të vitit kalendarik të mëparshëm që të përmbajë sa më poshtë:

- a) një përmbledhje dhe analizë të aktivitetit furnizues të të licencuarit;
- b) shitjet e energjisë elektrike dhe të dhënat për pagesat e faturave gjatë vitit;
- c) cilësinë e shërbimit të furnizimit dhe detajet e çdo mase të marrë për përmirësimin e shërbimit të furnizimit në zonë;
- d) çdo ndërprerje të energjisë elektrike;
- e) një përmbledhje dhe analizë të kontratave të lidhura për shitblerjen e energjisë elektrike që janë në fuqi gjatë vitit që raportohet;
- f) tabelën e treguesve të performancës siç përcaktohet në Kodin e Shpërndarjes;
- g) bilancin financiar të aktivitetit të licencuar.

8.3 Furnizuesit të kualifikuar mund t'i kërkohet të bëjë publik informacionin e mësipërm të dërguar në ERE, kur ky informacion konsiderohet nga ERE me interes për konsumatorin. Përfshimisht publikimi nuk do të kërkohet në rastet kur, me kërkesë të të licencuarit, ERE vendos që përmbushja e interesit publik nga publikimi i informacionit nuk justifikon dëmin e mundshëm tregtar ndaj të licencuarit.

8.4 Furnizuesi i kualifikuar është i detyruar të informojë ERE-n për çdo konflikt të kushteve të licencës së tij brenda 7 ditë-pune nga konstatimi i konfliktit nga i licencuari.

8.5 Furnizuesi i kualifikuar do t'i dorëzojë ERE-s, me kërkesën e këtij të fundit, në formën dhe brenda afatit të vendosur nga ERE, çdo informacion të nevojshëm për ERE-n.

8.6 Furnizuesi i kualifikuar do të ndajë shpenzimet e përbashkëta mes aktivitetit të tij të licencuar dhe aktiviteteve të tjera (përfshirë dhe ato të licencuara) në baza të arsyeshme në përputhje me paragrafët 8.1 dhe 8.2 të kësaj licence dhe praktikat e biznesit përgjithësisht të pranuara. Furnizuesi i kualifikuar do t'i paraqesë ERE-s dokumentacionin që paraqet bazat për ndarjen e shpenzimeve të përbashkëta, si dhe rezultatet e arritura.

8.7 Furnizuesi i kualifikuar do ta njoftojë ERE-n, brenda 10 ditëve për çdo ndryshim të :

- a) adresës;
- b) statutit të të licencuarit;
- c) certifikatës së regjistrimit;
- d) kodit fiskal;
- e) menaxherit kryesor.

8.8 Nëse furnizuesi i kualifikuar parashikon një situatë emergjence, siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi, furnizuesi i kualifikuar do të njoftojë pa vonesë ERE-n dhe ky njoftim do të përshkruajë çfarë masash do të marrë furnizuesi i kualifikuar për të parandaluar ose përmirësuar ndikimet e situatës së emergjencës së parashikuar.

8.9 Gjithë njoftimet zyrtare, aplikimet, peticionet dhe deklaratat lidhur me licencën duhet të jenë me shkrim.

9. Përdorimi i informacionit

9.1 Furnizuesi i kualifikuar do të sigurojë që çdo informacion i marrë nga të tjerët, si rezultat i aktivitetit të tij të licencuar, nuk do t'i jepet askujt, me përjashtim të rasteve kur:

- a) jepet pëlqimi paraprak me shkrim i personit me të cilin lidhet informacioni;
- b) informacioni është bërë publik;
- c) të licencuarit i kërkohet ose i lejohet ta përhapë informacionin për të përmbushur kushtet e kësaj licence, një urdhër të ERE-s ose çdo dispozitë ligjore të aplikueshme.

9.2 Furnizuesi i kualifikuar do të sigurojë që bizneset shoqëruese nuk do të përdorin asnjë informacion që disponon furnizuesi i kualifikuar për të fituar një avantazh konkurrues të pajustificuar, dhe do të sigurojë që nuk do ta përhapin informacionin tek asnjë person tjetër (përfshirë ata të një biznesi tjetër shoqërues) gjë që mund ta mundësojë këtë person të fitojë çdo lloj avantazhi komercial të pajustificuar.

9.3 Informacioni i dërguar ERE-s nga furnizuesi i kualifikuar do të konsiderohet publik me përjashtim të rasteve, kur me kërkesë specifike të të Licencuarit, ERE me vendim përcakton që ky informacion është i natyrës pronësore dhe se interesi publik i shërbyer nga përhapja e informacionit nuk do ta justifikojë ose kompensojë dëmin potencial komercial që i shkaktohet të licencuarit.

9.4 Furnizuesi i kualifikuar do të respektojë rregulloret dhe rregullat e aplikueshme të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe kompanive shpërndarëse të aprovuara nga ERE, përfshirë kryerjen e të gjithë urdhrave operative, instruksioneve ose udhëzimeve dhe dorëzimin e informacionit teknik dhe gjithë dokumentacionit tjetër të kërkuar.

10. Pagesat e rregullimit

10.1 Furnizuesi i kualifikuar do të paguajë pagesa rregullimi në mënyrë të rregullt e të vazhdueshme gjatë afatit të kësaj licence siç përcaktohet nga ERE, në përputhje me nenin 12 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe rregulloret e aplikueshme të ERE-s.

10.2 Nëse furnizuesi i kualifikuar nuk i paguan ERE-s pagesat e rregullimit sipas paragrafit 10.1 brenda afatit të kërkuar nga ERE-ja, furnizuesi i kualifikuar do të penalizohet në përputhje me nenin 64 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

11. Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes dhe transmetimit

Tarifat TPRSH dhe TPRT do të rregullohen dhe aprovohen nga ERE, në përputhje me metodologjitë përkatëse të miratuara nga ERE.

12. Aksesit në rrjetin e shpërndarjes dhe të transmetimit

12.1 Të licencuarve do t’u sigurohet akses në rrjetin shpërndarës dhe atë të transmetimit për t’u lidhur dhe për të përdorur facilitetet e tyre, për klientët e kualifikuar, në bazë të drejtë, të arsyeshme dhe jodiskriminuese.

12.2 Brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës nga një furnizues i kualifikuar, kompania e shpërndarjes ose OST do të përgjigjet duke i siguruar aplikantit informacionin lidhur me përdorimin e faciliteteve të tij shpërndarëse ose shërbime të tjera, përfshirë dhe informacione të detajuara mbi kushtet teknike, shërbimet dhe lejet shtesë të nevojshme, kërkesat për matjen e energjisë elektrike, përpunimin e informacionit, pagesën, termat dhe kushtet e marrëveshjeve. Furnizuesi i kualifikuar mund të ngarkojë pagesa shtesë për kryerjen e këtij informacioni.

12.3 Furnizuesi i kualifikuar do ta paguajë pagesën e aplikueshme për lidhjen. Furnizuesi i kualifikuar do t’i shlyejë pagesat e aplikueshme të lidhjes nëpërmjet pagesës së menjëhershme të shumës së plotë ose me pagesa mujore në pjesë të barabarta gjatë një periudhe të përcaktuar në marrëveshjen e lidhjes prej jo më pak se 6 (gjashtë) muaj.

12.4 Furnizuesit të kualifikuar mund t’i pezullohet shërbimi i siguruar nga kompania shpërndarëse ose OST, në përputhje me kodet e transmetimit, shpërndarjes dhe rregulloret dhe rregullat në fuqi, për çdo periudhë kohe gjatë së cilës veprimi ose mosveprimi i tij kërcënon sigurinë, qëndrueshmërinë ose cilësinë e operimit të rrjetit shpërndarës ose shërbimet e siguruar konsumatorëve të tjerë ose furnizuesve, ose gjatë situatave të emergjencës në furnizimin me energji elektrike siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi.

13. Kontrolli mbi kryerjen e aktivitetit të licencuar

13.1 ERE do të monitorojë zbatimin nga furnizuesi i kualifikuar të kushteve të licencimit, do të shqyrtojë raportet e marra nga furnizuesi i kualifikuar dhe, në çdo kohe, është i autorizuar të inspektojë librat e llogarive të të licencuarit dhe mund të kërkojë një auditim teknik dhe/ose kontabël të aktiviteteve të të licencuarit.

13.2 Përfaqësues të autorizuar të ERE-s kanë të drejtë të inspektojnë dhe të kontrollojnë ambientet e të licencuarit, pajisjet dhe dokumentet e tij për të verifikuar kryerjen e aktivitetit të licencuar në përputhje me kushtet e licencës, si dhe rregulloret dhe rregullat e ERE-s. Furnizuesi i kualifikuar do të sigurojë çdo ndihmë të kërkuar, të nevojshme për ERE-n gjatë këtij inspektimi.

13.3 Në bazë të ankesës së vërtetuar të çdo pale të tretë ose në bazë të propozimit të nisur kryesisht nga ERE, ky i fundit mund të nisë një hetim mbi zbatimin nga furnizuesi i kualifikuar të kushteve të licencës së tij ose rregulloreve dhe rregullave të ERE-s.

13.4 Furnizuesi i kualifikuar do të informojë ERE-n, duke dhënë shpjegimet dhe arsyet për çdo shkelje të këtyre kushteve të licencës brenda një jave që kjo shkelje i bëhet e njohur të licencuarit.

13.5 Furnizuesi i kualifikuar do t’u bindet vendimeve të marra nga ERE, përfshirë pagesën e gjobave të vendosura nga ERE, në përputhje me legjislacionin në fuqi, rregulloret dhe rregullat e ERE-s, dhe kushtet e kësaj licence.

14. Amendimi i licencës

14.1 ERE mund të amendojë kushtet e licencës në rast se ato nuk përputhen me:

a) Legjislacionin në fuqi.

b) Vendimet e formës së prerë të gjykatave të Republikës së Shqipërisë.

14.2 Në çdo kohë furnizuesi i kualifikuar ose ERE mund të propozojnë amendamente të tjera për këto kushte licence, përveç atyre të specifikuara në paragrafin 9.1, duke i transmetuar një propozim me shkrim, së bashku me çdo dokument mbështetës, palës tjetër.

14.3 ERE do të marrë vendimin përfundimtar vetëm pasi të marrë në konsideratë interesat e konsumatorëve dhe të licencuarve të tjerë. Palët e interesuara do të informohen me shkrim për çdo amendament të propozuar. Nëse ERE dhe furnizuesi i kualifikuar arrijnë një marrëveshje për këto amendamente, kushtet e licencës do të amendohen. Nëse marrëveshja nuk arrihet, furnizuesi i kualifikuar mund të apelojë në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë.

15. Heqja e licencës

15.1 ERE mund ta heqë licencën në përputhje me ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe rregulloret e miratuara nga ERE, kur:

- a) furnizuesi i kualifikuar kërkon revokimin e licencës;
- b) furnizuesi i kualifikuar shkel kushtet e licencës dhe nuk përmbush një ose disa nga detyrimet e shprehura në këtë licencë;
- c) furnizuesi i kualifikuar shkel legjislacionin në fuqi;
- d) furnizuesi i kualifikuar deklarohet i falimentuar dhe është i paafët të përmbushë detyrimet e kushteve të licencës;
- e) Furnizuesi i kualifikuar ka marrë licencë duke mashtruar.

15.2 Nëse furnizuesi i kualifikuar ndryshon statusin e tij ligjor ose nëse aksionari që kontrollon interesat ndryshohet pa autorizimin e ERE-s, licenca bëhet nul (e pavlefshme) dhe anulohet dhe pasuesi i të licencuarit do të aplikojë për një licencë të re, në përputhje me procedurat e ERE-s për dhënie licence.

16. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe e drejta për apelim

16.1 Çdo çështje e diskutueshme ose kërkesë mes të licencuarit dhe çdo përdoruesi të sistemit të transmetimit lidhur me aktivitetin dispeçerues ose kushtet e licencës do të zgjidhet sa më shumë që të jetë e mundur me mirëkuptim, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e rregullat e ERE-s.

16.2 Nëse zgjidhja nuk arrihet me mirëkuptim, atëherë ERE, në bazë të peticionit të çdo personi që është palë në këtë mosmarrëveshje, do ta zgjidhë mosmarrëveshjen dhe do ta nxjerrë vendimin e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e rregullat e saj.

16.3 Furnizuesi i kualifikuar mund të apelojë kundër vendimeve të ERE-s në gjykatë brenda 30 ditëve nga botimi i vendimit në Fletoren Zyrtare, sipas nenit 9 pika 4 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

16.4 Furnizuesi i kualifikuar do t’u bindet vendimeve të përkohshme të ERE-s në pritje të apelimit në gjykatë.

Republika e Shqipërisë
Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike

LICENCË E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR
PËR FURNIZIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE TË KLIENTËVE TË KUALIFIKUAR

Licenca i jepet:

Seria:

Numri i licencës:

Data e hyrjes në fuqi të këtij aneksi:

ANEKSI A
TERRITORI I AUTORIZUAR PËR AKTIVITETIN E LICENCUAR

ëFurnizuesi i kualifikuar _____, autorizohet të ushtrojë aktivitetin e furnizimit me energji elektrike të klientëve të kualifikuar në territorin e Republikës së Shqipërisë.]

VENDIM
Nr.68, datë 4.11.2005

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT E HEQJES SË NJË LICENCE

Mbështetur në nenet 9 dhe 18 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.11.2005, pasi shqyrtoi draftin e paraqitur nga Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit për “Rregulloren për procedurat e heqjes së një licence”,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores për procedurat e heqjes së një licence, bashkëlidhur këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

RREGULLORE PËR PROCEDURAT E HEQJES SË NJË LICENCE

PJESA E PARË DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 **Autoriteti**

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 18 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe në përputhje me rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s dhe rregullores për procedurat e licencimit miratuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Neni 2 **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të sigurojë një trajtim të barabartë e transparent, për të gjithë të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, për të cilët merret vendimi për të hequr një licencë, përmes vendosjes së procedurave të njëjta për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, në rastet e heqjes së një licence.

Neni 3 **Objekti**

Kjo rregullore përcakton procedurat që aplikohen për heqjen e një licence të dhënë sipas ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, rregullores për procedurat e licencimit, si dhe akteve nënligjore të tjera të miratuara nga ERE.

Neni 4 **Përkufizime**

Fjalët dhe frazat e mëposhtme të përdorura në këtë rregullore, kur përdoren, do të kenë kuptimet e mëposhtme:

1. “Ligji” do të thotë ligji nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.
2. “Bordi i Komisionerëve” do të thotë organi vendimmarrës i ERE-s, i përbërë nga pesë anëtarë të emëruar sipas procedurave të parashikuara nga ligji nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.
3. “ERE” do të thotë Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike.
4. “Licencë” do të thotë një autorizim që i jepet një personi sipas pjesës së tretë të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.
5. “I licencuar” do të thotë një person që mban një licencë të dhënë sipas pjesës së tretë të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.
6. “Procedurë” do të thotë një tërësi veprimesh, që kryhen në zbatim të legjislacionit në fuqi.

PJESA E DYTË PROCEDURAT E HEQJES SË NJË LICENCE

Neni 5 **Propozimi për fillimin e një procedure për heqje licence**

Një procedurë për heqjen e një licence, fillon me propozim të ERE-s, personave të interesuar, si dhe me kërkesë të mbajtësit të licencës. Kur kërkesa për heqje licence bëhet nga palët e interesuara, procedurat e heqjes së licencës do të fillojnë vetëm pas verifikimit nga personat e ngarkuar nga ERE, për të konstatuar se ekziston një rast për heqje licence.

Neni 6

Raportimi për nisjen e një procedure

Në çdo rast që personat e ngarkuar nga ERE konstatojnë shkeljet e mëposhtme:

- Mospërbushje të kushteve të licencës të dhënë sipas ligjit;
- Shkelje të dispozitave ligjore për mbrojtjen e mjedisit gjatë ushtrimit të veprimtarisë;
- Rrezikon shëndetin, jetën dhe pronën e njerëzve;
- Nuk shlyen pagesat e rregullimit të vendosura nga ERE;
- Nuk ka nisur veprimtarinë e licencuar brenda kohës së përcaktuar në licencë;
- Nuk arrin të përmbushë kushtet e licencës për shkaqe financiare,

i paraqesin Bordit të Komisionerëve një informacion mbi shkeljet e konstatuara, si dhe i propozojnë atij marrjen e një vendimi për të filluar procedurën për heqje licence.

Neni 7

Shqyrtimi fillestar

Një vendim i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për të proceduar me heqjen e një licence një të licencuari, do t'i njoftohet të licencuarit nga ERE, brenda 60 ditëve nga marrja e vendimit nga Bordi i Komisionerëve.

Neni 8

Njoftimi dhe përmbajtja e tij

Njoftimi për shkaqet që diktuan propozimin për nisjen e një procedure për heqjen e licencës do të përmbajë:

- Propozimin për heqjen e licencës;
- Shkaqet për heqjen e licencës;
- Të drejtën e të licencuarit për të kthyer përgjigje me shkrim, brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit.

Neni 9

Propozimi përfundimtar

Pas marrjes së përgjigjes me shkrim nga i licencuari brenda afatit të përcaktuar më sipër, personat e ngarkuar që ndjekin këtë procedurë, do ta shqyrtojnë këtë përgjigje brenda 15 ditëve dhe do të përgatisin një relacion për Bordin e Komisionerëve mbi argumentet e paraqitura dhe veprimet e ndërmarra nga i licencuari, dhe do t'i propozojnë Bordit të Komisionerëve për vazhdimin ose jo të procedurës së nisur për heqje licence ose për t'i dhënë mundësi të licencuarit, ndaj të cilit ka filluar procedura për heqje licence, që të mënjanojë brenda 30 ditëve shkaqet për të cilat është propozuar heqja e licencës

Neni 10

Vendimi i Bordit

1. Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas nenit 9 të kësaj rregulloreje, dhe pasi është njohur me përgjigjen e të licencuarit, Bordi i Komisionerëve do të vendosë për heqjen ose jo të licencës.

2. Në rast të marrjes së vendimit për heqje licence, nga Bordi i Komisionerëve, ERE njofton Këshillin e Ministrave, në përputhje me nenin 18, paragrafi i fundit i ligjit.

Neni 11

Njoftimi për vendimin

Në përfundim të një procedure për heqje licence, ERE do të njoftojë të licencuarin mbi

përfundimin e procedurës së nisur ndaj tij, si dhe do t'i dërgojë një kopje të vendimit të Bordit të Komisionerëve.

Neni 12
Shqyrtimi gjyqësor

Kundër vendimit të Bordit të Komisionerëve për heqjen e licencës, i licencuari mund të bëjë ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga botimi i vendimit në Fletoren Zyrtare.

Neni 13
Kushte të përkohshme

1. Kur Bordi i Komisionerëve i heq licencën një të licencuari, aplikon masat e parashikuara në nenin 18 pika 4 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe rregulloren për procedurat e licencimit.

2. Aplikimi i masave të përkohshme do të zgjasë deri në përfundimin e procedurave për shpronësimin e aseteve me vendim të Këshillit të Ministrave dhe dhënien e një licence të re.

PJESA E TRETË
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 15
Amendamente të rregullores

Këto rregulla janë objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, në përputhje me rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s.

Neni 16
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas publikimit të saj në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

VENDIM
Nr.69, datë 14.11.2005

PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGISË ELEKTRIKE SHOQËRISË KURUM ENERGY SHA, PËR KLIENTIN E KUALIFIKUAR KURUM INTERNATIONAL SHPK

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1, germa ç dhe nenit 45 pika 2 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.27, datë 30.5.2004 “Rregullorja për procedurat e licencimit”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 14.11.2005, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria Kurum Energy sh.a., për marrjen e licencës së furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Dhënien e licencës së furnizuesit të kualifikuar, me afat 1 vit, shoqërisë Kurum Energy sh.a., për furnizimin e klientit të kualifikuar “Kurum International” sh.p.k., e cila mbështet financiarisht shoqërinë

Kurum Energy sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr.70, datë 14.11.2005

**PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR AKTIVITETIN E IMPORTIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE
SHOQËRISË KURUM ENERGY SHA PËR KLIENTIN E KUALIFIKUAR KURUM
INTERNATIONAL SHPK**

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1, germa dh të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.27, datë 30.5.2004 “Rregullorja për procedurat e licencimit”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 14.11.2005, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria Kurum Energy sh.a., për marrjen e licencës së importit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Dhënie e licencës së importit, shoqërisë Kurum Energy sh.a., me afat 1 vit, për klientin e kualifikuar “Kurum International” sh.p.k., e cila mbështet financiarisht shoqërinë Kurum Energy sh.a.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr.72, datë 17.11.2005

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 26 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, me ndryshimet përkatëse, neni 11, germa A dhe neni 22, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 17.11.2005, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Spahiu Gjanç” sh.p.k., për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit, për përcaktimin e çmimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “Spahiu Gjanç” sh.p.k.
2. Ngarkohet Departamenti i Tarifave dhe i Çmimeve për zbatimin e këtij vendimi, dhe të informojë shoqërinë “Spahiu Gjanç” sh.p.k., për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm, në zbatim të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, si dhe vendimit nr.60, datë 29.12.2004 të Bordit të Komisionerëve “Për miratimin e të dhënave bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë

elektrike nga prodhuesit e vegjël”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr.73, datë 17.11.2005

PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE,
PËR SHOQËRINË “FAVINA” SHPK PËR VITIN 2005

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa b, 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe vendimit nr.60, datë 29.12.2004 të Bordit të Komisionerëve “Për miratimin e të dhënave bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël”, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 17.11.2005, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Favina” sh.p.k., për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për HEC-in Vithkuq të rrethit të Korçës,

VENDOSI:

1. Mosmiratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga shoqëria “Favina” sh.p.k., për H/C-in Vithkuq të rrethit të Korçës, me arsyetimin e mosdërgimit të të dhënave të sakta në aplikimin e paraqitur në ERE nga kjo shoqëri, si dhe mosndarja e llogarive për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

Fletorja Zyrtare gjendet: duke u abonuar pranë: njërive postare të qyteteve;
Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
- në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot"
Tel: 042 555 63; 267 468
www.legjislacionishqiptar.gov.al ose www.qpz.gov.al

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

**REGJISTRAT E NOTERISË SIPAS FORMATIT TË MIRATUAR
NGA MINISTRIA E DREJTËSISË 2005**

1. Regjistri i depozitimit të parave ose vlerave të tjera
2. Regjistri i përgjithshëm i akteve dhe i veprimeve materiale
3. Regjistri i testamenteve
4. Indeksi alfabetik

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1.	PËR PROKURIMIN PUBLIK.....	1500
2.	PËR NËPUNËSIN CIVIL (Botim, 2005)	600
3.	PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë, Vëllim i II-të, Botim 2005)....	1500
4.	PËR TAKSAT DHE TATIMET.....	1500
1.	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004 ...	1500
2.	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004.....	2000

BOTIME TË REJA

1. KODI DOGANOR
2. KODI DETAR

Doli nga shtypi më 30.11.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Mësonjëtorja"
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë